

## Njoftim për Shtyp

### Sfidat e të rinjve dhe të moshuarve në kohën e ndryshimeve

**Tiranë, 25 nëntor 2015** – Dinamikat e jetës kanë sjellë një ulje të lindshmërinë në Shqipëri nga Indeksi më i lartë në Europë, në nivelin aktual me 1.7 fëmijë për grua - nën nivelin e zëvendësimit. Si pasojë, përbërja e popullsisë së Shqipërisë ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore midis periudhave të censuseve të vitit 1979 dhe 2011, duke ulur numrin e të rinjve dhe fëmijëve nën moshën 15 vjeç nga 37 përqind në vetëm 21 përqind të popullsisë, konstaton studimi i INSTAT mbi të Rinjtë në Shqipëri,

Kjo rënie do të jetë forca parësore e moshimit të popullsisë, një proces që ka filluar të ndihet në shoqërinë shqiptare. Për shkak të efektit të kombinuar të rritjes së jetëgjatësisë në rritje, uljes së lindshmërisë dhe emigrimit në rritje të të rinjve, përqindja e të moshuarve në popullsi - 65 vjeç e lart - në periudhën 1989 deri në 2011 është rritur nga 5 në 11 përqind, evidenton studimi i dytë i INSTAT mbi Mplakjen e Popullsisë.

Qëllimi i studimeve është vënia në fokus e dinamikave të popullsisë duke siguruar një pamje të qartë të situatës aktuale të të rinjve dhe të moshuarve në Shqipëri, bazuar në analizat e thelluara të të dhënave statistikore sipas CENSUS 2011 dhe studimeve të tjera të realizuara nga INSTAT.

- Vlerësohet se 225 mijë të rinj kanë emigruar në periudhën ndërmjet censusit 2001-2011, shumica për në Itali dhe Greqi. Kjo shifër përfaqëson një faktor të rëndësishëm në **rëniën e përgjithshme të popullsisë me pothuajse 9 përqind** në këtë periudhë.
- Popullsia e **emigrantëve të rinj gjithnjë e më shumë përbëhet nga femrat** si tendencë e vënë re në dhjetëvjeçarin e fundit 2001-2011.
- Në vitin 2011, përqindja e të rinjve 25 deri në 29 vjeç që **kanë përfunduar arsimin e lartë** ka qenë **24 përqind**, krahasuar me vetëm 8 përqind në vitin 2001.
- Të dhënat tregojnë një ulje të mëtejshme të treguesve të tregut të punës të të rinjve 15-29 vjeç: **normë e ulët e pjesëmarrjes në tregun e punës (nga 43 në 28 përqind)** dhe një **normë më e lartë papunësie (nga 22 në 33 përqind)**.
- Për të rinjtë që nuk kanë gjetur punë, vërehen **nivele të larta të mospërputhjes së aftësive** të tyre profesionale dhe kërkesave të tregut të punës. Norma e mospërputhjes për punëtorët e rinj me arsim të lartë në vitin 2011 ishte **34 përqind** në 2011.
- **Vetëm 12 përqind** mes të rinjve të martuar dhe **29 përqind mes bashkëmoshatarëve seksualisht aktivë të pamartuar** zgjedhin **metoda moderne kontracepsioni** për të mbrojtur veten kundër shtatzënive të padëshiruara.
- Si pasojë, kemi **normë të lartë të aborteve** në Shqipëri, që do të thotë se **në çdo gjashtë shtatzëni, njëra përfundon me abort** të induktuar. Gjatë vitit të fundit, **6,400 femra u përballën me rrezikun** e pashmangshëm të shëndetit nga një abort i induktuar.

Nga ana tjetër, numri në rritje i të moshuarve paraqet sfida dhe kërkon përgatitje për t'i përballuar ato:

- Procesi i moshimit do të vazhdojë edhe për disa dekada, dhe numri i të moshuarve projektohet që të përbëjë **33 përqind të popullsisë së përgjithshme active** në vitin 2031.
- Censusi i vitit 2011 tregon se **23 përqind e të moshuarve kanë qenë me aftësi të kufizuara** (krahasuar me vetëm 3 përqind në popullsinë e të rriturve nën moshën 65 vjeç).

- Pothuajse **gjysma e grave të moshuara janë vejusha** dhe u mungon mbështetja praktike dhe emocionale që zakonisht ofron martesat.
- Rreth **30 përqind e të moshuarve jetojnë në njësi ekonomike familjare me dy persona** zakonisht me bashkëshortin/bashkëshorten e moshuar, ndërsa **8 përqind jeton vetëm**, duke u bërë kështu më vulnerabël.
- Në vitin 2012, përqindja e të moshuarve që **nuk ka mundur të arrijë nivel konsumi** që konsiderohet minimum për një standart bazë jetese, është vlerësuar në **10 përqind**.
- Po ashtu, **10 përqind e të moshuarve, përfshihen akoma në punë**.
- Aksesit në mjete moderne të komunikimit mbetet i ulët: **vetëm 15 përqind e të moshuarve** kanë kompjuter dhe **vetëm 9 përqind kanë lidhje interneti** në shtëpitë e tyre. Nga ana tjetër, **83 përqind e tyre kanë telefon celular**.

Një indeks i përbërë i vulnerabilitetit që përdor sistemimin në banesë, aftësinë e kufizuar dhe varësinë e të ardhurave si variabla të pavarur, tregon **një përhapje të gjerë të vulnerabilitetit** në mbarë vendin, por **me përqendrimin më të madh në veri-lindje** të Shqipërisë. Has, Kukës, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat dhe Pukë në pjesën veri-lindore të vendit janë bashkitë me nivelet më të larta të vulnerabilitetit.

Zj. Emira Galanxhi, Drejtoreshë e Statistikave Sociale, transmetoi në emër të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, Z. Gjergji Filipi, rëndësinë e të kuptuarit të një transformimi të tillë të thellë demografik, sfidat sociale dhe ekonomike që ky transformim sjell, si edhe cilat janë sjelljet dhe vendimet e përfshira në këto përvoja. “Është po aq e rëndësishme që shoqëria shqiptare dhe politikë-bërësit të jenë të mirëpërgatitur për këto fenomene, të cilat do ta japin impaktin e tyre në dekadat që vijnë në fushën social-ekonomike të vendit”, tha Zj. Galanxhi.

“Të kuptuarit si duhet e situatës së të rinjve dhe të moshuarve në Shqipëri është baza për të marrë masa më të mira sociale dhe ekonomike”, tha Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, Z. Christoph Graf. “Për të marrë vendime për politika të mira, të dhënat, faktet dhe shifrat janë kyç në Shqipëri, një vend ku zakonisht mbizotërojnë hamendësimet, perceptimet dhe interpretimet, duke mjegulluar kështu realitetin dhe kërkimin e të vërtetës”. Ambasadori Graf gjithashtu përmendi disa gjetje interesante dhe shqetësuese nga dy studimet, që kanë të bëjnë me tendencën për emigrim tek të rinjtë dhe plakjen e popullsisë.

“Të rinjtë në Shqipëri ende përbëjnë një pjesë të mirë të popullsisë shqiptare, prandaj investimi në arsimimin dhe shëndetin e tyre, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues, merr një rëndësi të dorës së parë për rolin që do të luajë në produktivitetin e Shqipërisë dhe zhvillimin e saj në të ardhmen.

Për aq kohë sa njerëzit janë në qendër të zhvillimit, të drejtat e tyre njerëzore, nevojat dhe mirëqenia e tyre duhet të jenë vëmendja kryesore e politikave, strategjive dhe planeve të zhvillimit.”, - tha Dr. Manuela Bello, Asistente Përqafësuese e UNFPA në Shqipëri.

Këto dy studime u kryen nga INSTAT dhe UNFPA, në kuadër të “Mbështetjes së Kombeve të Bashkuara për Programin e Përfshirjes Sociale” financuar nga Zyra e Koperacionit Zviceran në Shqipëri. me kordinimin e Qendrës Kombëtare për Studime Sociale.

\*\*\*

Për më shumë informacion ju mund të kontaktoni:  
Zj. Emira Galanxhi, [egalanxhi@instat.gov.al](mailto:egalanxhi@instat.gov.al)  
Z. Bart de Bruijn, [b.j.debruijn@online.nl](mailto:b.j.debruijn@online.nl)